



7.06.2022	
09-1129/1	

Në bazë të Marrëveshjes në mes Agjencionit për punësim të Republikës së Maqedonisë, Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Komunës së Tetovës, në bazë të Planit operativ për programe aktive dhe masat për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022 i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së veriut, Programi për punë të dobishme komunale finansuar nga Buxheti i Agjencionit për punësim të Republikës së Maqedonisë, më 07.06.2022 shpall

### Konkurs publik deri te evidenca e personave të papunë për përfshirje në Programin për punë të dobishme komunale

Thirren të gjithë personat e evidentuar si të papunë që janë të interesuar të përfshihen në Programin për punë të dobishme komunale, projekti "Veprimtari edukativo – arsimore për fëmijë parashkollorë" në shkollat e mesme për angazhim në mardhënie pune me orar të shkurtuar në periudhë prej 9 (nëntë) muajve me qëllim të aftësimin dhe dalëngadalë të përfshirjes në tregun e punës, të paraqiten në Agjencionin për punësim-qendra për punësim në Tetovë.

Personat e evidentuar si të papunë që nuk kanë një certifikatë/vërtetim të pranuar nga institucionet përkatëse për aftësitë/kompetencat e fituara për profesionet në sferën sociale dhe shëndetësore sipas shërbimit që do të duhet të ofrohet do të përfshihen në program dhe do të marrin 3 muaj trajnim të detyrueshëm dhe 6 muaj pune.

**Periudha e plotë për përfshirje të personave të papunë përmes programës është 9 muaj, ku përfshihet edhe trajnimi edhe angazhimi në punë.**

Personat e evidentuar si të papunë që do të përfshihen në "Programin për punë të dobishme komunale" do të jenë të angazhuar në mardhënie pune me orar të shkurtuar 20 (njëzet) orë në javë, me çrast gjatë trajnimit të detyruar prej 3 muajve për personat që nuk kanë një certifikatë/vërtetim të pranuar nga institucionet përkatëse për aftësitë/kompetencat e fituara për profesionet në sferën sociale dhe shëndetësore në bazë të shërbimit që duhet të ofrohet dhe gjatë angazhimit në punë prej 6 (gjashtë) muajve /9 (nëntë) muajve statusi i personave të papunë ngelet i pandryshuar, ndërsa personat e papunë-shfrytëzues të kompensimeve financiare dhe shfrytëzuesve të së drejtës së ndihmës së Garantuar minimale gjatë angazhimit në punë do e kenë aktive të drejtën e fituar më parë.

Kandidatët që do të zgjidhen dhe do të përfshihen në "Programin për punë të dobishme komunale" është paraparë që do të paguhet nga 9.000,00 mkd bruto në muaj, gjatë kohës së trajnimit dhe angazhimit në punë, ku përfshihet tatimi personal dhe sigurimi në rast të aksidenteve në punë ose sëmundje profesionale.

Personat e evidentuar si të papunë që do të përfshihen në "Programin për punë të dobishme komunale" duhet t'i përkasin njërës nga kategoritë e personave të papunë:

- personat e papunë të evidentuar në Agjencionin për punësim së paku 1 vjet,
- personat e papunë të rrinjë (deri në 29 vjet) të evidentuar në Agjencionin për punësim së paku 6 muaj,
- persona shfrytëzues të ndihmës së garantuar minimale

Pozitat e punës që përfshihen në këtë konkurs u referohen angazhimit të :

**Vendi i punës 1:** Përkujdesës në arsimin parashkollor

Pozicionet për vendin e punës 1: 4 pozicione

Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës 1: persona që kanë mbaruar shkollën e mesme medicinale, shkollë të mesme – drejtimi gjimnaz i përgjithshëm, shkollë e mesme edukate fizike, ( me ose pa licencë)

**Vendi i punës 2:** Edukatore në arsimin parashkollor

Pozicionet për vendin e punës 2: 2 pozicione

Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës 2: Profesor i diplomuar i arsimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve parashkollorë, pedagog i diplomuar për arsimin parashkollor dhe pedagog i diplomuar / ( me ose pa licencë.)

Personat e papunë të interesuar për pjesëmarrje në projektin “Punë e dobishme komunale” paraqitjet për aplikim duhet t’i dërgojnë në arkivin e Qendrës për punësim Tetovë nga data 07.06.2022 deri më 14.06.2022 nga ora 08:00-14:00.

Kushtet më konkrete, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen në kontratën mes Komunës së Tetovës dhe kandidatëve të zgjedhur.

Informata detale të Programës “Punë të dobishme komunale” mund të merren në komunën e Tetovës tek personat Besare Osmani Bilalli, Idriz Shaqiri dhe Besir Ameti që janë kordinator komunal të Programës, Xhevair Abdullahu nga Agjencioni për punësim-Qendra për punësim Tetovë dhe Magdalena Veselinovska nga Qendra për punë sociale Tetovë.

KRYETAR

Bilall Kasami

